

PUSHKINI DHE KONCEPTI I TIJ PËR FEMRËN E DASHURINË, KËNDVËSHTRUAR PËRMES DITARIT SEKRET

Dr. ILIR SHYTA

Pedagog

Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë

Universiteti “Fan S. Noli”

Korçë

ilirshyta@yahoo.com

Abstrakt: Objekt i kësaj kumtese është poetika e Pushkinit përmes një qasje sqaruese, e cila buron nga ditari sekret i tij, mbajtur në vitet 1836-1837, duke thyer tabu në koherencë.

Marrëdhëniet që shkrimtari vendos me gjuhën e bëjnë veprën letrare, gjithnjë sipas Proust-it, vendin e “të shpikurit” më shumë në “të shprehurit” e vetvetes.

Në një lexim tjetër, të ndryshëm nga ai i deritanishmi, në paralelizëm, hidhet dritë mbi gjenium shkrimtar dhe elementë të jetës private. Njerëzit i shprehin afeksionet e tyre përmes letërsisë, në sintoni me gjuhën e trupit... Dashuria poetike pushkiniane mbetet e jetësuar në vargje, ndërsa përmes saj hidhet dritë edhe mbi anë të panjohura, intime, të jetës së autorit. Duhet thënë, se deri më tani nuk ka pasur një interpretim ndryshe të poezive për shkak të mendësisë së kritikës socrealiste, që nuk guxonte të bënte një interpretim të tillë, pikëvështruar përmes ditarit sekret të Aleksandër Pushkinit. Poezia na adreson, se duke u nisur prej saj në receptim, disa krijimeve poetike të Pushkinit, mund t’ju bësh një qasje tjetër kuptimore. Këtë e tregon vetë interesi që ngjall ditari sekret ndër lexues, duke rritur më shumë kërshërinë e tyre, rreth veprës së poetit.

Ky receptim i ndryshëm, sjell konotacion të pafundëm për lexuesin dhe artin pushkinian. Për qasja në kohë na përforcon idenë, se një poezi mund të lexohet shumë herë dhe në mënyra të ndryshme interpretuese.

Fjalë-kyçe: Ditar, shkrimtar, letërsi, tabu, vlera.

PUSHKIN’S VIEW ON WOMAN AND LOVE, SEEN THROUGH THE SECRET DIARY

Abstract: The object of this article is Pushkin’s poetics through an explanatory approach, which originates from his secret diary, kept in the years 1836-1837, breaking the taboo on coherence.

The relations that the writer establishes with language make the literary work, always according to Proust, the place of “inventing” more in the “expression” of oneself.

In another reading, different from the one so far, in parallel, light is shed on the writing genius and elements of private life. People express their affections through literature, in tune with body language... Pushkin's poetic love remains alive in verses, while through it light is shed on unknown, intimate aspects of the author's life. It must be said that until now there has not been a different interpretation of the poems due to the mindset of the Socialist Realism critic, who did not dare to make such an interpretation, viewed through the secret diary of Alexander Pushkin. The poem addresses us, that starting from it in the reception, some of Pushkin's poetic creations, you can make a different approach to meaning. This is shown by the interest that the secret diary arouses among readers, increasing their curiosity about the poet's work.

This different reception brings endless connotations for the reader and Pushkin's art. The time approach reinforces the idea that a poem can be read many times and in different interpretive ways.

Keywords: *Diary, writer, literature, taboo, value.*

Disa poezi të Pushkinit hapin polemikë, me receptimin e tyre ndër lexues. Të tilla poezi si A. P. Kernës; *Kujtoj me mall një çast gëzimi; Koketës; Letra e djegur* apo *Të huajës* marrin konotacion personal pushkinian. Agron Tufa vëren se “*Pushkini kishte dozën e vet të fortë prej donzhuanit. Në poezitë e tij janë të kamufluara një shumësi e madhe femrash të epokës. Ndër të cilat ka qenë p.sh. A. P. Kerna (Ana). Ana Kerna është e identifikuar, ka qenë personazh real historik. Ekzistojnë madje dhe portrete të saj. Por vini re:*

Kujtoj me mall atë çast takimi/ Kur para meje u shfaqe ti,/ Si vezullim i një vegimi,/ Si engjëll plot me bukuri.

Vazhdon poezia në 6-7 strofa, një perlë e lirikës së Pushkinit dhe ky engjëll që duket sikur nuk i prekin flatrat në tokë, që është gjithmonë një frymëzim i diafragmës së lartë, paraqitet në shënimet e ditarit të tij krejt ndryshe...” (Tufa 2015:2)

Këto shënime së pari u botuan në SHBA më 1986 nga shtëpia botuese M.I.P. Comany, në Minneapolis me një tirazh që shkonte në 100 mijë kopje, duke u kthyer në bestseller. Ditari është përkthyer në Japoni, Francë, Gjermani, Itali, Greqi etj. Botimi i parë i librit në USA është

bërë në gjuhën ruse. Pikërisht, aty, në këtë ditar sekret Pushkini shkruan:

“Me Kernin, për shkak të mendjelehtësisë së saj, kam folur vetëm për gjëra pa rëndësi. Te ajo më habiste vetëm trupi i saj i shkëlqyer. Dhe nuk është faji im që shuma e femrave më josh e më habit vetëm me trupin.

Ka edhe raste kur takoj gra të zgjuara dhe mendjeholla. Me to është kënaqësi të bisedosh, sidomos për një marrëdhënie të zjarhtë. Këto femra të rralla nuk ankohen kurrë se veç trupit ato nuk paskan vlerë tjetër, sepse, së pari, e dinë mirë se nuk është kështu, dhe, së dyti, ato janë aq të zgjuara sa ta kuptojnë se po të shprehen në këtë mënyrë, bëhen qesharake.(Pushkin 2000:119) Ose ...pasi të jetë ngopur me të, ai të jetë në gjendje të vlerësojë mendien, talentin, mirësinë dhe gjithçka të bukur që mund të ketë ajo.”(Pushkin 2000:120)

Në ditarin sekret Pushkini shkruan për veten. Madje saktëson Tufa, “...këtu zë fill një dukuri: përdorimi i niveleve të ndryshme të gjuhës. Një nivel gjuhe përdoret për artin dhe një nivel tjetër në ditar. Pra është i njëjti subjekt femëror, i cili shfaqet në dy trajta. Në rastin e parë, siç është poezia, pra engjëll, ndërsa në shënimet e ditarit ai është krejt në anën e kundërt kur thotë, p. sh.: Atë ditë, kur me ndihmën e Zotit, iu shtiva në dorë ... Dhe hyn në hollësi fiziologjike.”(Tufa 2015:3)

Ditari sekret i Pushkinin na fton për një lexim ndryshë të titujve poezive të tij, të përmendura më sipër, duke mundësuar dy receptime në të njëjtën kohë. Poezitë kështu duken edhe më interesante në interpretimin e tyre. “Duke e flakur “të folmen e përditshme”, “shprehjet gjysmë të gatshme”, gjithë sa “na vijnë nga të tjerët” dhe nga të tjerë më të këqinj se ne, “na japin për realitet vetëm një njohje konvencionale”, ku shkrimtari vërtet synon të zbresë në atë “qetësi të thellë ku mendimi për zgjedh fjalët në të cilat do të mishërohet. Duke u larguar nga gjuha e zakonshme, të shkruarit lejon të rrokësh atë që deri dje nuk qe rrokur ende prej të menduarit. Edhe për këtë arsye vepra nuk është as “produkti” as “pasqyrimi” i një realiteti paraekzistues, por është një “zanafillë”, “një ndodhi e re. [...] Kritika tradicionale, madje edhe degë të reja, si psikokritika apo sociologjia e letërsisë, për interpretimin e veprës të degdisin te një “gjetiu”, te një gjësend jashtë saj (veprës): te jeta e shkrimtarit apo historia dhe shoqëria e kohës, ndërkohë që ky konceptim i ri i letërsisë, përkundrazi, të shtyn kah një “kritikë e brendshme”. Për atë që di të lexojë,

marrëdhëniet e shkrimtarit me botën e me njerëz të tjerë, si dhe me vetveten, gjenden në plotësinë e tyre aty, në vepër. Aty është sheshi, tek shkrimtari e zbulon veten, madje e shpik. Do të ishte e kotë ta kërkoje një shkrimtar në dokumente arkivore. Të shkruarit përfytyrohet si një “fshetje”, një “strukje”, një “bishtnim” prej realitetit ekzistues për t’u ngujuar në hapësirën e gjuhës dhe të letërsisë”. (Echo 1968:173)

E pashprehshmja nuk shfaqet në thurrimën e veprës e analizuar, por vepra e analizuar afrohet ndaj nesh si një mekanizëm që përfiton të pashprehshmen. Përkufizimi i këtij mekanizmi do të ishte *përkufizimi i emocionit estetik*. (Lanson 1991:18) Një libër i cili do që të të mbajë, të vazhdojë, është një libër që duhet të na japë mundësi ta lexojmë në shumë mënyra, d.m.th. *“mundësi për lexime të ndryshme, të ndryshueshme, të ndërrueshme”*. (Echo 1968:173) Echo thotë se një vepër arti, edhe kur ajo është formë e kryer dhe e “mbyllur” në përkryerjen e vet si organizëm përpikshmërisht i kalibruar, është “e hapur” së paku për aq sa mund të interpretohet në mënyra të ndryshme pa iu tjetërsuar veçanësisht e saj e pacënueshme. (Echo 1962:84)

Veprat e mëdha të shkrimtarëve të mëdhenj, jetojnë nëpër kohë. Ato nuk vdesin, por përjetësohen. *“Meraku për seks është më i fuqishmi nga meraqet njerëzore. Kur nxiten nga ky merak, njerëzit zhvillojnë mprehtësi të imagjinatës, fuqi të vullnetit, këmbëngulje dhe aftësi krijuese të panjohur për ta në kohë të tjera. Kaq i fuqishëm dhe nxitës është merakun për kontakt seksual, sa që njerëzit rrezikojnë lirisht jetën dhe reputacionin për ta kënaqur atë. Kur shfrytëzohet dhe rodrejtohet nëpër vija të tjera, kjo forcë motivuese i mirëmban të gjitha atributet e veta të mprehtësisë së imagjinatës, të guximit etj., që mund të përdoren si forca të fuqishme krijuese në letërsi, në art apo në çfarëdo profesioni a zanati tjetër, duke përfshirë, natyrisht edhe grumbullimin e begatë”*. (Hill 2018: 206) Ndërkaq, Hill sërish vijon të argumentojë tezën e tij. *“Burrat që kanë grumbulluar pasuri të mëdha dhe kanë arritur famë të jashtëzakonshme në letërsai, në art, në industri, në arkitekturë dhe në profesione, ishin të motivuar nga ndikimi i një gruaje”* (Hill 2018: 207)

Në këtë këndvështrim, organizimi i domethënësit në tekstin letrar sjell një mugullim të vijueshëm marrëdhëniesh të brendshme, që i mbeten çdo lexuesi t’i zbulojë gjatë leximit të tij. Shpjegimi tradicional i tekstit, që brengoset vetëm për “letrarësinë”, nuk i pranon “kuptimet e figurëshme”. Ndërkohë, metodat e reja kritike priren t’i shumëfishojnë

këto kuptime; vetë sprovat e bëra gjatë një aventure japin shembuj të këtyre ndryshimeve në mënyrën e të lexuarit. Edhe estetika e receptimit e ka pranuar “papërcaktueshmërinë” e tekstit letrar, “ambiguitetin” që qëndron në thelbin e tij. (Plasari 1996:102)

Jauss-i është i mendimit se interpretimet e reja të një vepre të së shkuarës mbrohen ndaj tepërive arbitrare nëpërmjet caqeve dhe kushteve të horizontit historik dhe shoqëror. Për të kuptuar çështjet që një vepër parashtron, duhet ta lidhim atë me “horizontin e pritjes” së “lexuesve të parë”. Nga ana tjetër, vargu i njëpasnjëshëm i kuptimeve që tashmë i janë dhënë të njejtit tekst përgjatë historisë, ka logjikën e vet. Ai krijon një traditë interpretimi, ndaj së cilës, një interpretim i ri duhet të vendosë një qëndrim të ri, si në rastin e poezive të veçanta nga të tjerat. Një poezi është krijuar për t’u marrë e rimarrë, për t’u lexuar e rilexuar në pafundësi herësh dhe kuptimesh. *“Pushkini ishte tjetër, ishte një lule ekzotike: ezmer, i fortë, me kaçurrela. Mes dëborës ruse dhe një race të bardhë, Pushkini ishte tërheqës, kishte atë shkëndijën magjike tërheqëse jo vetëm si ligjërues, bashkëbisedues, ishin një tok cilësish të përbashkëta të karakterit që e bënë të ishte lider. Pushkini kishte prejardhje etiopiane. Ishte shtatshkurtër, afër mesatares, por mprehtësia e tij, zotërimi elegant i gjuhëve, mënyra për të sintetizuar çdo kontekst ose replikë, e bënë të ishte i kërkuar gjithkund...”*(Tufta 2015:3) Madje ai arrin deri aty sa shkruan edhe për bashkëshorten e vet, Natalia Gonçarovën, duke supozuar se çfarë mund t’i ketë bërë Cari asaj. Pushkini xhelozohej për të. *“Kur shikoj se si Cari i hedh gruas sime vështrime të zjarra, i kundërpërgjigjem duke e vështruar dhe unë perandoreshën në mënyrë aq të pacipë, sa ta shikoj mirë dhe ai. Me këtë dua ta bëj të mendojë se pasioni i tij për gruan e tjetrit shpaguhet me pasionin tim për gruan e tij”.*(Pushkin 2000:169) Ajo në ditar një herë del me emrin Natalia, një herë me inicialin N. dhe një herë me emrin përkëdhelës Nina.

“Por gjëja më e tmerrshme që ne nuk mund ta marrim vesh lehtë është nëse gruaja është apo jo besnike. Unë nuk e di asnjherë se çbën në fakt N., kur nuk e shikoj. Besnikëria ruhet vetëm me anë të besimit. Ajo vetëm mund të besohet. Kur besimi im dobësohet, do të thotë se te unë vjen djalli i xhelozisë dhe asnjë provë besnikërie nuk mund të më ndihmojë, sepse në çdo provë aryeja gjen një papërsosmëri. Vetëm rikthimi i besimit në zemër largon xhelozinë. Por ç’e do, vetëm për një farë kohe.”(Pushkin 2000:50) Ose *“Besnikëria është luftë me joshjen*

për të mos qenë besnik. Dhe mua nuk më mjaftuan forcat në këtë luftë. Kur e pashë se kjo dobësi do më sillte fatkeqësi, fillova t'ia mbushja mendien N. Të jetonim në fshat. E dija se nuk do t'i bëja ballë joshjes, kurse vetmia do të mbante lidhur pas tryezës së punës” (Pushkin 2000:51) Ose sërish: “Arrita t’i mbush mendjen Ninës se dantesi kishte sifilizin dhe infekton çdo grua që shkon me të... Ajo më besonte deri Katja i tregoi se kjo ishte fund e krye një gënjeshtër. (Pushkin 2000:63) Përsëri Pushkini vijon në ditarin e tij sekret: “Nuk kam forca t’i qëndroj besnik sime shoqeje. Unë e çmoj vërtet atë te gratë e tjera dhe e kërkoj medoemos nga e imja. Madje modelin e saj e kam paraqitur te Tatjana. Edhe N. mundohet shumë. S’e lënë të qetë edhe njerëzit që e përflasin sikur nuk e pëlqeka poezinë time”. (Pushkin 2000:146)

Tatjana është personazhi femëror të cilën autori e pikturon me ngjyrat e fjalëve të tij. Ajo ka të gjitha cilësitë e një femre mahnitëse për ne, lexuesit. Të gjitha virtytet njerëzore autori i skaliti në këtë personazh femëror, e cila bëhet model për kohën, por jo vetëm për kohën kur është shkruar, një personazh i tillë mbetet i dashur edhe në kohën tonë. “Autori në romanin “Eugjen Onjegini” ngriti lart figurën e femrës, gjë që ishte e pazakonshme për kohën dhe sistemin shoqëror-politikë, sepse në atë kohë fare pak autorë mund ta ngritnin figurën e femrës në pedestalin në të cilin e ngriti Pushkini. Ai bëri hapin e parë dhe kështu krijoi një figurë femër madhështore, e cila u bë model për autorë tjerë të mëvonshëm vendas dhe botërorë”. (Tufa 2015:4)

“Një mikut mund t’i behesha mike/ Dhe shoqe e jetës e besnike/ Dhe zonjë e ndershme për shtëpi./ Një tjetër... jo askujt në jetë/ Nuk do t’i falnja dashuri!/ E ka vendosur Qielli vetë, jam e jotja në perjetësi;/ Gjithë jeta ime më pat qenë/ Një peng se ty do të takoj/ Se Zoti jetën ma ka dhënë/ Që gjer në varr të adhuroj...” ose: “Mendja fillon të më lëshojë/ Në heshtje duhet të humbas./ Të pres ti eja siç ma k’ënda/ Dhe shpresat ngjallm’ i përsëri,/ A ma prish ëndrrën që tashi/ Me të qortuara të rënda!” (Pushkin 2000:89)

Theksojmë se: “Forma e romaneve si **Onegini** është krijuar nga Bajroni; të paktën mënyra e tregimit përzjerja e prozës dhe e poezisë në realitetin e paraqitur, apostrofat, thirrjet e poetit drejtuar vetvetes dhe sidomos prania e ndjeshme e personit të poetit në veprën e krijuar nga ai, gjithë kjo është puna e Bajronit. Sigurisht, të përvetësosh, formën e re të huaj për subketin tënd, nuk është njësoj si ta krijosh vetë atë; me gjithë atë kur krahason Oneginin e Pushkinin me **Don Zhuanin**,

Çaild Haroldin dhe Bepon e Bajronit, nuk mund të gjesh asgjë të përbashkët, përveç formës dhe mënyrës të veçantë të të shkruarit personal.”(Bjelinski 1960:52)

Ndër poezitë e tjera që futen në këtë grupim, janë edhe poezitë “Sa ju kam dashur!”, “Letra e djegur”, “Kujtoj me mall një çast gëzimi”, “Koketës”...(Pushkin 2009:18;25;60;82)

-Ndofta dashuria/ Nuk është shuar krejt në shpirtin tim!/ Po s’dua që prej dhembjeve të mia/ Të ngryseni sërish në dëshpërim.

“-Oh, lamtumirë, o letër! Ajo me porositi.../ Sa po më dridhet dora tani prej dhembshurisë!/ Si mund t’i djeg gëzimet që më kish patur shpirti?!/ Po mjaft, erdhi ora, digju, o letër e dashurisë!

-Dhe rreh me gaz kjo zemra ime/ Sepse ju kthyen perseri/ Dhe perendi, dhe frymezime/ Dhe lote, e jete, e dashuri.

-S’më prek betimi qesharak/ Dhe djallëzitë m’u mërzitën/ Por edhe juve jo më pak/ Besoj ju lodhën tradhtitë/ Të ftoht’u bëmë dhe të matur/ Dhe s’presim të na thot’ njeri,/ Se e përjetshmja dashuri

-Ndofta dashuria/ Nuk është shuar krejt në shpirtin tim!/ Po s’dua që prej dhembjeve të mia/ Të ngryseni sërish në dëshpërim.

-Oh, lamtumirë, o letër! Ajo më porositi.../ Sa po më dridhet dora tani prej dhembshurisë!/ Si mund t’i djeg gëzimet që më kish patur shpirti?!/ Po mjaft, erdhi ora, digju, o letër e dashurisë!

-S’më prek betimi qesharak/ Dhe djallëzitë m’u mërzitën;/ Por edhe juve jo më pak

Besoj ju lodhën tradhtitë;/ Të ftoht’u bëmë dhe të matur/ Dhe s’presim të na thot’ njeri,/ Se e përjetshmja dashuri/ Tri javë e shumta mund të zgjatet.”

Duhet thënë se për këto poezi ka pikëtakime të tjera me femra inicialet e të cilave gjenden në ditarin sekret të Pushkinit (1836-1837). Përmendim A., Z, K., N. N., etj. Pushkini ishte një nga zëdhënësit virtuozë jo vetëm të shpirtit poetiko-lirik të rusëve, por edhe i filozofisë së përgjegjësive të tyre në dashuri. Poeti i romantizmit rus, kurrsesi nuk mund të linte jashtë kësaj ndjesie poetikën e tij, e cila bëhet edhe më e bukur në këndvështrimin receptues. Nën tisin e kësaj qasjeje analizuese, lexuesi mbetet më i drejtpërdrejtë me një realitet që nuk është vështirë ta riprodhosh, si dikur edhe në ditët tona.

BIBLIOGRAFIA

1. A. S. Pushkin. *Ditari sekret 1836-1837*, Shtëpia botuese Fan Noli, Tiranë, 2000
2. A. S. Pushkin. *Poezi, poemë, drama në vargje*, Shtëpia botuese Argeta LMG, Tiranë, 2009
3. A. Pushkini. *Eugjen Onjegini*, Shtëpia botuese Argeta LMG, Tiranë, 2000
4. A. Plasari, *Fishta i dashuruari*, Shtëpia botuese “Marlin Barleti”, Tiranë 1996
5. Napoleon Hill. *Mendo dhe pasurohu*, Shtëpia botuese Pema, 2018
6. V. G. Bjelinski. *Artikuj kritikë*, Shtëpia botuese Naim Frashëri, Tiranë, 1960
7. <http://www.infoelbasani.al/tatjana-i-shkruan-onjeginit-letra-e-famshme-per-vajzat-e-mira-qe-te-ben-ti-duash-fort/>